



VENDIM 31-12/ 2011

Ne pajtim me nenin 36 paragrafi 1, nën paragrafi 1.17 dhe nenin 65 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur me datë 04 gusht 2011, lëshon këtë:

UDHËZIM

PËR ZBATIMIN E AKTVENDIMEVE PËR PËRMBARIM DUKE DEBITUAR LLOGARITË BANKARE TË KLIENTËVE

Neni 1

Përshkrimi i Përgjithshëm

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës (BQK) ka vërejtur se Kosova përballlet me problemet e shumta në zbatimin e aktgjykimeve për përmbarim duke debituar llogaritë bankare të klientëve. Në veçanti raportohet se vendimet e gjykatave që kërkojnë ngrirjen apo transferin e mjeteve nga llogaria e debitorit në llogarinë e kreditorit nuk ekzekutohen në kohë të duhur, ose në disa raste nuk ekzekutohen fare, pavarësisht faktit se këto vendime janë definitive.

Një situatë e tillë është shqetësim për tërë sektorin financiar, pasi që zbatimi në pajtueshmëri me vendimin definitiv të gjykatave është një nga shtyllat e besimit afarist dhe ekonomisë së tregut.

Me qëllim të zbatueshmërisë efektive të Aktvendimeve për përmbarim, respektivisht me qëllim të zbatimit të dispozitave të Ligjit për Procedurën Përmbarimore lidhur me Përmbarimin për kredinë sipas llogarisë në Bankë, të avancimit të përgjegjësisë që bankat komerciale kanë për zbatimin e Aktvendimeve për Përmbarim duke debituar llogaritë bankare të klientëve, BQK e lëshon këtë udhëzim për të arritur qëllimet e përmendura më lartë.

Neni 2

Fushëveprimi

2.1 BQK me anë të këtij Udhëzimi vendosë masat e nevojshme që pasqyrohen në mënyrën e zbatimeve të aktvendimeve për përmbarim, duke debituar llogaritë e klientëve në secilën bankë komerciale të licencuar nga BQK.

2.2 Ky Udhëzim ju adresohet të gjitha Bankave Komerciale që veprojnë në Kosovë dhe janë të licencuara nga BQK.

Neni 3

Përkufizimet

3.1 Për qëllimet e këtij Udhëzimi, termi “Zbatimi i Aktvendimeve për përmbarim” do të kuptohet si ekzekutimi i kërkesave duke debituar llogaritë bankare të debitorit të gjykuar në bazë të një vendimi të plotfuqishëm gjyqësor për ekzekutim ashtu siç definohet me dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbarimore të Kosovës.

3.2 Për qëllimet e këtij Udhëzimi termi “klient” do të kuptohet si:

1. një person juridik që ka llogari bankare në një bankë komerciale në Kosovë; ose
2. një person fizik që ka llogari bankare të hapura në një bankë komerciale në Kosovë

Neni 4

Obligimet dhe Sanksionet

4.1 Banka Komerciale me të pranuar Aktvendimin për përmbarim nga ana e Gjykatës, do të verifikoj brenda afatit ligjorë se a përmban Aktvendimi për përmbarim informatat si më poshtë:

- emrin e gjykatës, që ka lëshuar vendimin si dhe numrin dhe datën e vendimit;
- emrin e debitorit, numrin e llogarisë bankare dhe numrin e regjistrimit të biznesit (nëse personi juridik ose personi fizik merret me biznes)
- emrin e kreditorit, adresën dhe llogarinë bankare aktuale;
- shumën e borxhit (borxhin kryesor, kamatën dhe shpenzimet) të specifikuar në Aktvendim për përmbarim; dhe
- nënshkrimin dhe vulën e gjykatës që e ka lëshuar Aktvendimin për përmbarim;

Banka komerciale do të konfirmoj pranimin e Aktvendimit për përmbarim me vulën e saj zyrtare duke shënuar datën dhe kohën në të cilën është pranuar dokumenti duke mbajtur një kopje të vulosur për vete.

4.2 Aktvendimi për përmbarrim duhet të zbatohet nga ana e bankës komerciale në afatin e përcaktuar ligjor ndaj të gjitha mjeteve që mbahen nga klienti në llogaritë bankare si në Euro po ashtu edhe mjetet ekuivalente në valutë të huaj, përveç mjeteve të cilat janë të përjashtuara me ligj nga ekzekutimi.

4.3 Nëse Aktvendimi për përmbarrim është konstatuar se nuk është valid ose se nuk përmban të gjitha shënimet të përmendura si nën 4.1, dhe mungesa e këtyre shënimeve sipas mendimit të bankës komerciale e bënë atë urdhër gjyqësor të pa ekzekutueshëm, një vendim i tillë do t'i kthehet gjykatës brenda afatit të përcaktuar me ligj, me një shkresë përcjellëse në të cilën konstatohen arsyet e kthimit. Bankat komerciale do ta përcjellin një kopje të kësaj shkrese edhe tek Drejtorati për Mbikëqyrje bankare në BQK.

4.4 Pas përfundimit të tentimeve që të zbatoj Aktvendimin për përmbarrim, banka komerciale do të i raportojë rezultatet e veprimeve të veta brenda afatit ligjor gjykatës që ka lëshuar atë dhe Drejtoratit për Mbikëqyrje bankare të BQK-së.

4.5 Nëse banka komerciale raporton mjete jo të mjaftueshme në llogaritë e specifikuar për të përmbushë Aktvendimin për përmbarrim atëherë ajo duhet të i dërgojë gjykatës dhe Bankës Qendrore kopjen e saktë me të dhënat e llogarisë bankare të debitorit për periudhën që fillon 30 ditë para se Aktvendimi për përmbarrim të lëshohet dhe përfundon me ditën kur raporti i është dërguar gjykatës në bazë të paragrafit 4.4 të këtij neni. Kopja e të dhënave duhet të ketë shënimet e rregullta nga llogaria dhe të përmbajë të gjitha depozitat, tërheqjet dhe të gjitha transaksionet në llogari të bëra gjatë periodës raportuese. Kopja e të dhënave duhet të verifikohet nga zyrtari i bankës komerciale dhe të nënshkruhet nga ai me deklaratë se informatat janë të vërteta. Përveç kësaj emri dhe titulli i zyrtarit bankar duhet të shkruhet qartë në raport.

4.6 BQK do të ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme që të sigurojë se bankat komerciale dhe personat përgjegjës të cilët nuk i përmbushin obligimet e tyre sipas legjislacionit në fuqi dhe këtij udhëzimi do të i nënshtrohen masave ndëshkuese nga ana e BQK-së dhe lidhur me këto masa do ta njoftojë edhe gjykatën.

4.7 Ftohen të gjitha gjykatat kompetente, që në ditën e parë të secilit muaj ta njoftojnë BQK-në me një listë komplete të Aktvendimeve për përmbarrim të dërguara nga gjykatat tek secila bankë komerciale e që nuk janë ekzekutuar nga bankat, sipas informatave vijuese:

- Emrin e gjykatës që ka lëshuar Aktvendimin;
- Numrin dhe datën e vendimit;
- Emrin dhe informatat tjera identifikuese për debitorin;
- Banka ku është dërguar Aktvendimi për përmbarrim;
- Emri i kreditorit dhe shuma e borxhit;

4.8 Duke u bazuar në kompetencat sipas legjislacionit në fuqi, BQK kohë pas kohe do të inspekton të dhënat tek bankat komerciale që të bindet se ato i kanë respektuar obligimet e lartshënuara.

Neni 5

Bashkëpunimi

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës dhe të gjitha Bankat Komerciale do të bashkëpunojnë ngushtë me të gjitha Gjykatat Themelore në Kosovë duke siguruar një përkrahje të ndërsjellë me qëllim ekzekutimin efikas të vendimeve gjyqësore.

Neni 6

Hyrja në Fuqi

Ky vendim do të hyjë në fuqi me datën 05 gusht 2011. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi shfuqizohet vendimi Nr. 01-01/2011 i datës 26 janar 2011.

Gani GËRGURI

Guvernator